

GJYKATA E APELIT PRISHTINË, trupi gjykues i përbër nga Gjyqtarja e EULEX-it Franciska FISER si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtari i Kosovës Isa KELMENDI dhe Gjyqtari i Kosovës Kujtim PASULI si anëtar të trupit gjykues, në lëndën penale të paditësit EA nga Gjilani, rruga “R. P.” nr. 26, kundër të paditurve JS dhe DS, të përfaqësuar nga VP dhe EQ, që të dy avokat nga Gjilani për padi të konfirmimit të pronësisë së pronës së patundshme në vlerë të kontestit prej 250 EUR, për ankesën e të paditurit DS të datës 7 Qershor 2011 kundër Gjykatës Komunale të Gjilanit (tani Gjykata Themelore e Gjilanit), Aktgjykimit C. nr. 610/2002 të datës 12 Dhjetor 2002, pas marrjes së vendimit të mbajtur me datë 9 Shtator 2013, lëshon këtë

AKTVENDIM

APROVOHET ankesa e të paditurit DS e datës 7 Qershor 2011 si e bazuar ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Gjilanit (tani Gjykata Themelore e Gjilanit) C. nr. 610/2002 e datës 12 Dhjetor 2002 **ANULOHET** dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C. nr. 610/2002 me paragrafin 1 të dispozitivit ka aprovuar padinë e paditësit EA dhe konfirmoj se ndaj të paditurve JS dhe DS, paditësi EA është pronar i parcelës kadastrale nr. 457/1, i ashtuquajtur vend “Gavran”, me kulturë arë e klasës së dytë, me sipërfaqe prej 00.22.00 ha, e regjistruar në Fletën Poseduese nr. 406, ZK e Gjilanit dhe se kjo e drejtë është kërkuar mbi bazën e përkujdesjes. Prandaj të paditurit u obliguan që të ia njohin këtë të drejtë paditësit ndërsa Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Prona e Gjilanit u obligua që në bazë të këtij Aktgjykimi të bëjë ndryshimet në librat gjegjëse të kadastrës.

Më tej, me paragrafin 2 të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, gjykata vendosi se shpenzimet e procedurës civile do të sigurohen nga paditësi.

Kundër aktgjykimit është parashtruar brenda afatit ligjor ankesa nga i padituri DS për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestuese, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa dhe të anulohet në tërësi aktgjykimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Një kopje e ankesës i është dërguar paditësit por se nuk është parashtruar asnjë përgjigje ndaj ankesës brenda afatit ligjor.

Në bazë të Nenit 513 paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestuese dhe Ligjit nr. 04/L-118 mbi Përmirësimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestuese (tani e tutje LPK 2008) dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestuese (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së” nr. 4/1977, 36/1980, 69/1982, 58/1984, 74/1987, 57/1989, 20/1990, 27/1990, 35/1991 dhe “Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 27/1992, 31/1993, 24/1994 dhe 12/1998) (tani e tutje LPK 1977) janë aplikuar në këtë procedurë gjyqësore të shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi dosjen e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet e ankesës dhe pas vlerësimit të tyre në përputhshmëri me nenin 366 paragrafi 1 të LPK-së të 1977, gjeti se ankesa është e bazuar.

Fillimisht Gjykata e Apelit sipas Nenit 365 paragrafit 2 të LPK-së së 1977 shqyrtoi *ex officio* se a ka shkelje esenciale në zbatimin e procedurës nga Neni 354 paragrafi 2 i të njëjtit ligj dhe të korrigoj zbatimin sipas ligjit.

Lidhur me shkeljet esenciale ekzistuese të ushtrimit dhe procedurës nga neni 354 paragrafi 2 i LPK-së së 1977; po ashtu duke marr parasysh pretendimet e ankesës se gjykata e shkallës së dytë nuk është munduar në asnjë mënyrë të ia dërgoj padinë të paditurve dhe kështu të paditurve iu është mohuar mundësia për t’u përgjigjur në padi; Gjykata e Apelit gjen se është bërë shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore siç është cekur në pikën 7 (8) pasi që me mos dërgimin e fletëthirrjeve dhe dokumenteve të tjera të pandehurve iu është mohuar mundësia për të folur para gjykatës.

Gjykata e Apelit gjen nga dosja e lëndës se paditësi asnjëherë nuk është obliguar nga gjykata e shkallës së parë të plotësoj padinë me vendbanimin e tanishëm të të paditurve siç kërkohet me Nenin 281 lidhur me Nenin 109 paragrafët 1 dhe 2 të LPK-së së 1977.

Përveç kësaj asnjëherë asnjë fletëthirrje nuk iu është dërguar të paditurve nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë që zyrtarisht të vërtetojnë se ata nuk mund të gjenden në adresat e tyre të fundit të regjistruara në Gjilan.

Po ashtu nuk është ndërmarr asnjë veprim nga ana e gjykatës së shkallës së parë për të siguruar informata për adresat aktuale të të paditurve siç parashihet me Nenin 148 të LPK-së së 1977.

Njëjtë është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore siç u cekë në pikën 10 (11) pasi që përfaqësuesi i të paditurve nuk kishte autorizimin e duhur për të vepruar. Nuk kishte aktvendim për emërim të një përfaqësuesi të përkohshëm siç parashihet me Nenin 278 paragrafi 1 të LPK-së së 1977. Gjykata nuk njoftoj po ashtu institucionet kompetente të kujdestarisë në mënyrë që të iniciohet caktimi i kujdestarëve të tyre siç parashihet me Nenin 84 paragrafin 3 të LPK-së së 1977.

Veç kësaj gjykata e shkallës së parë nuk vërtetoi disa fakte kyçe për shkak të së cilave ekziston gjithashtu vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike siç parashihet me Nenin 355 të LPK-së së 1977.

Në gjykatën e shkallës së parë është mbajtur vetëm një seancë dhe janë dëgjuar dy dëshmitar. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar deklaratat e tyre dhe nuk i ka krahasuar ato me pretendimet e paditësit nga padia. Njëjtë gjykata e shkallës së parë nuk vlerësoi besueshmërinë e tyre pasi që ata janë vetëm 22 apo 23 vjeçar kur gjoja është lidhur kontrata.

Gjykata e shkallës së parë nuk vërtetoi të paktën faktet kyçe si: kur saktësisht u lidh kjo kontratë dhe kur u realizua, kur paditësi morri pronën në pronësi faktike, cili ishte çmimi kontraktues, kur u pagua nga ana e paditësit, kush dhe kur u ndërtua ndërtesa që gjendet në pronë, kur të paditurit u larguan nga Kosova dhe nëse u larguan nga Kosova pas vitit 1978 a reagueshin ata në ndonjë mënyrë kur i padituri filloi të shfrytëzoj patundshmërinë në vitin 1978.

Pasi që situata faktike u përcaktua jo plotësisht, atëherë gabimisht u aplikua e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë sipas Nenit 356 të LPK-së së 1977.

Gjatë ri-gjykimit duhet të kihen parasysh gjitha të sipërpërmendurat si dhe dy çështje tjera si në vijim.

Së pari gjykata duhet t'i kushtoj kujdes faktit se i padituri JS vdiq me 30 Dhjetor 2006. Kështu gjykata e shkallës së parë do të pezulloj procedurën gjyqësore sipas Nenit 277 të LPK-së së 2008, lidhur me Nenin 513 paragrafi 2 të LPK-së së 2008 në mënyrë që të

vërtetoj se kush janë trashëgimtarët e të ndjerit JS pasi që ata duhet të përfshihen në procedurën gjyqësore gjithashtu.

Dhe së dyti sipas Nenit 36 të LPK-së së 2008-es gjykata e shkallës së dytë do të vërtetoj *ex officio* saktësinë e vlerës së objektit në kontest të caktuar në padi në vlerë prej 250 € dhe të lëshoj aktvendim adekuat lidhur me këtë.

Nga të sipërpërmendurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në përputhshmëri me nenin 366 paragrafi 1 të LPK-së së 1977.

KËSHILLË JURIDIKE: Nuk lejohet ankesë kundër këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Ac. no. 5361/2012

9 Shtator 2013

Kryetarja e Trupit Gjyqësor:

Franciska FISER

E përpiluar në gjuhën angleze, si gjuhë zyrtare.